


5. POZICIONI FINANCIAR I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE

(29) Gjatë periudhës, pozicioni kreditor i individëve është zgjeruar, ndërsa pozicioni debitor i bizneseve¹⁸ është ngushtuar. Për sektorin e individëve, rritja e depozitave me 3% ka qenë më e shpejtë se rritja e kredisë me 1.8%, dhe kontributin kryesor në rritjen e depozitave e ka dhënë monedha e huaj¹⁹. Si rezultat i kësaj ecurie, pozicioni kreditor i sektorit është zgjeruar me 3.2%. Për sektorin e biznesit, depozitat u rritën me 4.7%, ndërsa kredia u tkurr me 0.8%²⁰. Edhe në këtë rast, kontributi i monedhës së huaj ka qenë i rëndësishëm. Si rezultat, pozicioni debitor i bizneseve u ngushtua me 7.1%.

Grafik 21. Pozicioni financiar i individëve dhe bizneseve (miliardë lekë)



(30) Sipas të dhënave të fundit të vitit 2018, kursimet e individëve rezidentë u rritën me 1.2% ose me 13 miliardë lekë gjatë periudhës, por mbeten 16 miliardë lekë më të ulëta në krahasim me fundin e vitit 2017. Depozitat në lekë dhe në valutë vijojnë të zënë mbi 80% të kursimeve të përgjithshme të individëve, ndërkohë që investimet në obligacione, bono thesari dhe në fondet e investimeve zënë përkatësisht 6.9%, 5.3% dhe 5.1% të totalit të mjeteve financiare të individëve. Gjatë periudhës, individët kanë rritur investimet e tyre në formën e depozitave (kryesisht në formën e depozitave në valutë), ndërkohë që investimet në bono thesari dhe në fonde investimi kanë rënë lehtë në terma nominalë (përkatësisht me 8% dhe 10%) dhe në peshë, ndaj strukturës së investimeve.

Tabelë 3. Aktivet e individëve rezidentë në sistemin financiar

	2016, dhjetor		2017, qershor		2017, dhjetor		2018, qershor		2018, dhjetor	
	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %	mld lek	Pesha %
Depozita në lekë	454.3	40.3	465.1	42.1	467.2	41	456.7	41.1	462.8	41.2
Depozita në valutë	476.4	42.3	432.8	39.2	469.5	41.2	447.1	40.3	464.6	41.4
Bono thesari	65.2	5.8	67.3	6.1	63.6	5.6	65.1	5.9	59.4	5.3
Obligacione	64.5	5.7	67.9	6.1	72.1	6.3	77.4	7	77.1	6.9
Fondet e investimeve	65.4	5.8	70.8	6.4	65.1	5.7	62.5	5.6	57.3	5.1
Fondet e pensioneve private vullnetare	1.2	0.1	1.3	0.1	1.6	0.1	1.8	0.2	2.1	0.2
Portofoli i individëve	1,127.00	100	1,105.20	100	1,139.10	100	1,110.60	100	1,123.30	100

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

¹⁸ Kjo analizë mbështetet vetëm mbi të dhënat për depozitat dhe kreditë e bizneseve dhe individëve në sektorin bankar.

¹⁹ Edhe zhvillimet vjetore janë në të njëjtin kah, por në këtë rast për shkak të rritjes më të shpejtë të kredisë me 3.9%, kundrejt rritjes së depozitave me 1.0%. Në rritjen e kredisë, kontributin kryesor e ka dhënë monedha vendase.


²⁰ Edhe në këtë rast, zhvillimet vjetore mbeten në të njëjtin kah, ku rritja e depozitave me 5.4%, u shoqërua me rënien e kredisë me rreth 2.0%.



5.1. KREDITIMI I INDIVIDËVE²¹ DHE RREZIKU I KREDISË

(31) Gjatë periudhës, kredia për individë u rrit me 1.8%²². Rritja ka ardhur si pasojë e rritjes së kredisë për individët në lekë, gjë që ka sjellë edhe rritje të peshës së kredisë në lekë në strukturën e përgjithshme të kredisë²³. Brenda kredisë në valutë, pesha e kredisë së pambrojtur në valutë ndaj tepricës totale të kredisë në valutë dhënë individëve ra në 46.5%, nga rreth 52% një gjashtëmujor dhe një vit më parë.

Grafik 22. Struktura e kredisë për individë sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(32) Cilësia e portofolit të kredisë së individëve është përmirësuar gjatë gjithë vitit 2018, dhe kontributin kryesor e ka dhënë kredia në lekë. Gjatë periudhës, raporti i kredive me probleme ra me 1.2 pikë përqindje në nivelin 6.4%²⁴. Për portofolin në lekë, raporti i kredive me probleme ra me 1 pikë përqindje, në nivelin 5.5%, ndërsa raporti i kredive me probleme në valutë shënoi 8.8%, pa ndryshime të rëndësishme gjatë vitit. Tek portofoli në valutë, cilësia e portofolit të kredisë së pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit është përmirësuar ndjeshëm²⁵. Rritja e nivelit të arkëtimeve vijon të japë kontributin kryesor në rënien e kredisë me probleme për individët.


²¹ Analiza mbi strukturën e kredisë sipas afatit dhe monedhës, i referohet vetëm individëve rezidentë.

²² Vetëm për individët rezidentë, rritja ishte 1.7%. Në terma vjetorë, rritja e kredisë për individët ishte rreth 3.8% dhe për individët rezidentë 3.5%.

²³ Pesha e kredisë në lekë arriti në 65.5%, duke qenë përkatësisht 1.2 dhe 6.2 pikë përqindjeje më e lartë se në qershor 2018 dhe dhjetor 2017.

²⁴ Përmirësimi në raportin e kredisë me probleme për individët vijon që prej muajit qershor 2015.

²⁵ Raporti i kredisë me probleme për kredinë e pambrojtur në valutë u ul në 8.7%, nga 10.7% në qershor 2018 dhe 9.8% në dhjetor 2017.



HAPËSIRË INFORMUESE 5.1: REZULTATET E VROJTIMIT MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E FAMILJEVE

Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së familjeve kryhet çdo gjashtë muaj, mbi një kampion rastësor prej 1210 familjesh, nga të cilat 54% jetojnë në zonat urbane dhe 46% në zonat rurale të vendit.

Gjatë periudhës, numri total i të punësuarve në kampionin e vrojtuar ka shënuar rritje, krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Në terma vjetore, rritja ka ardhur nga rritja e të punësuarve në sektorin privat dhe rritja e numrit të të vetëpunësuarve, ndërkohë që numri i të punësuarve në sektorin shtetëror ka rezultuar në rënie gjatë vitit.

Niveli i përgjithshëm i të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve, në tërësi, është rritur. Rritja e të ardhurave ka qenë disi më e lartë në krahasim me shpenzimet, gjë që ka sjellë një përmirësim të lehtë të balancës financiare (të ardhura – shpenzime) të familjeve.

Rreth 26% e familjeve të përgjigjura deklarojnë se kanë hua për të paguar. Kjo peshë ka rënë me 2 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe një vit më parë, duke mbetur nën mesataren historike të vrojtuar. Tek këto familje, indekset e të ardhurave dhe të shpenzimeve kanë shënuar rënie gjatë periudhës.

Totali i tepricës së raportuar të huasë rezulton në rënie krahasuar me vrojtimin e kaluar dhe një vit më parë. Rreth 70% e vlerës së huasë është siguruar nga burime formale dhe 30% nga burime joformale. Kjo strukturë, reflekton rënie në ndjeshme të huamarrjes formale krahasuar me 6-mujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Ndryshimi mund të jetë kryesisht statistikor, i theksuar nga procesi i rishikimit të kampionit të familjeve të intervistuar.²⁶

Rreth 86% e huasë është marrë në lekë, ndërsa 14% në euro. Rreth 27% e tepricës së huasë deklarohet për blerjen/riparimin e një prone, 44% për zhvillimin e një biznesi dhe vetëm 9% për konsum. Gjatë periudhës së vrojtuar, pesha e huamarrjes për “blerje/riparim prone” ka shënuar rënie, ndërkohë që pesha e huamarrjes për “zhvillim biznesi” dhe për “konsum” është rritur.

Familjet huamarrëse raportojnë se kësti i huasë, gjatë periudhës referuese, ka rënë, si pasojë e rënies në normën e ponderuar të interesit të kredisë për individët. Rreth 59% e familjeve huamarrëse deklarojnë se aftësia e tyre paguese nuk ka ndryshuar, ndërsa pjesa tjetër deklarojnë kryesisht përmirësim krahasuar me 6-mujorin paraardhës dhe me një vit më parë. Për gjashtëmujorin e ardhshëm (gjysma e parë e vitit 2019), shumica e familjeve huamarrëse (rreth 80% e familjeve) nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese, ndërsa balanca neto e pjesës tjetër të të përgjigjurve tregon pritje më të dobëta.


Mundësia për të marrë hua gjatë pjesës së parë të vitit 2019, **vlerësohet disi në rënie krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë**, gjë që dëshmon për një kërkesë ende të paqëndrueshme të familjeve për huamarrje.

²⁶ Si pjesë e rishikimit të rregullt të kampionit të intervistuar, për këtë vrojtim janë ndryshuar nga INSTAT rreth 20% e familjeve të kampionit.




(33) Ngarkesa me borxh e familjeve mbetet në nivele relativisht të përshtatshme dhe ka ardhur në rënie. Nga vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së familjeve rezultojnë se, në fund të gjashtëmujorit të dytë 2018, rreth 26% e familjeve shqiptare kanë të paktën një borxh për të paguar. Kjo peshë ka rënë krahasuar me dy periudhat paraardhëse dhe është 3 pikë përqindjeje nën mesataren historike (që prej vitit 2010). Nëse analizohet ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve të familjeve huamarrëse, konstatohet që indeksat e të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre kanë rënë gjatë periudhës, pothuaj në të njëjtën masë.

Grafik 23. Indeksi i të ardhurave dhe shpenzimeve për familjet huamarrëse



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 24. Huamarrja sipas raportit "kësti i huasë/të ardhura totale mujore"



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(34) Gjatë periudhës ka ndodhur një zhvendosje e lehtë e shpërndarjes së huamarrjes në favor të raporteve më të larta këst huaje/të ardhura të familjes. Raporti i pagesës ndaj totalit të të ardhurave arrin "deri në 10%" për 40% të familjeve huamarrëse, "10-30%" për 35% të familjeve dhe "mbi 30% të të ardhurave" për 26% të familjeve. Peshë e familjeve që raportojnë se pagesa e kredisë ndaj totalit të të ardhurave është mbi 30% është rritur me 6 pikë përqindjeje në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit.


(35) Kërkesa për huamarrje e familjeve vijon të mbetet e moderuar. Sipas vrotimit, rreth 63% e të përgjigjurve kanë deklaruar se "nuk presin të marrin hua të re në 6 muajt e ardhshëm", dhe kjo peshë është rritur lehtë krahasuar me 6-mujorin e kaluar. Indeksi i mundësisë për të rimarrë një hua të re ka rezultuar 0.157²⁷, si dhe ka rënë lehtë ndaj vlerës së llogaritur nga vrotimi i kaluar dhe krahasuar me një vit më parë, duke mbetur nën mesataren afatgjatë. Tek

²⁷ Indeksi është llogaritur si mesatare e peshuar e përqindjes së përgjigjeve për secilën alternativë me koeficientët përkatës. Për përcaktimin e koeficientëve, intervali 0-1 është ndarë në nënintervale me gjatësi të barabartë 0.33 njësi. Koeficientët për secilën alternativë rezultojnë: 0 ("nuk ka asnjë mundësi"), 0.33 ("ka pak mundësi"), 0.66 ("ka shumë mundësi") dhe 1 ("është e sigurt"). Indeksi i përfutur merr vlera nga 0 në 1, ku sa më afër 0 të rezultojë vlera e indeksit, aq më e vogël është mundësia për të marrë hua të re dhe, sa më afër 1-shit, aq më e lartë mundësia për të marrë hua të re në 6 muajt e ardhshëm.




huamarrësit që deklarojnë se planifikojnë të marrin hua, pesha e huamarrësve të rinj (që nuk kanë borxh) është rritur lehtë, në 59%.

Grafik 25. Indeksi i marrjes/rimarrjes së një huaje në 6 muajt e ardhshëm (Total i kampionit)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 26. Familjet që planifikojnë të marrin hua në 6 muajt e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.2. KREDITIMI I BIZNESEVE²⁸ DHE RREZIKU I KREDISË

(36) Gjatë gjysmës së dytë të vitit, teprica e kredisë së dhënë për bizneset është zvogëluar dhe ndikimin kryesor në këtë ecuri e ka dhënë kredia për bizneset rezidente. Pesha e kredisë në valutë vijon të luhet rreth vlerës 62%, pa shënuar ndryshime gjatë periudhës, ndërsa pesha e kredisë së pambrojtur nga lëvizjet e pafavorshme të kursit të këmbimit ndaj totalit të kredisë për bizneset u ngjiti në nivelin 25%²⁹. Në strukturën e kredisë për bizneset sipas afatit të maturimit, është vërejtur një rritje e lehtë e kredisë afatshkurtër dhe afatmesme, përkundër rënies së kredisë afatgjatë³⁰. Teprica e kredisë së dhënë për bizneset rezidente³¹, gjatë periudhës, u tkurr me 3.1 miliardë lekë (ose me 1%), në nivelin 318 miliardë lekë. Kontribut në këtë ecuri dhanë tkurrja e tepricës së kredisë për “pasuri të paluajtshme” dhe asaj për “kapital qarkullues”. Sipas monedhave, kontributin kryesor në ngushtimin e tepricës së kredisë për bizneset rezidente, gjatë periudhës, e dha tkurrja e kredisë në monedhën vendase, me rreth 1.8 miliardë lekë (ose 1.4%), ndjekur nga kredia në dollar amerikan, e cila u tkurr me 1.3 miliardë lekë (ose 6%).

²⁸ Analiza mbi strukturën e kredisë sipas afatit dhe monedhës, i referohet vetëm bizneseve rezidente.


²⁹ Pesha e saj, në qershor 2018 dhe dhjetor 2017, ishte sa përkatësisht 23.8% dhe 24.7% e totalit të kredisë për bizneset.

³⁰ Kredia afatshkurtër dhe ajo afatmesme u ngjiten në nivelin 31.6% dhe 19.8% përgjatë periudhës, përkatësisht 2.2 p.p dhe 1.2 p.p më të larta se një gjatshëmujor më parë; ndërsa, kredia afatgjatë ra me 3.4 p.p, duke zbritur në nivelin prej 46.6%.

³¹ Përbën rreth 62% të kredisë për subjektet rezidente.




Grafik 27. Struktura e kredisë për bizneset sipas afatit të maturimit (majtas) dhe monedhës (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

(37) Gjatë vitit 2018, është rritur pesha e kredisë për bizneset e vogla dhe të mesme. Peshat e kredisë për këto dy kategori të bizneseve janë ngjitur përkatësisht në 24.6% dhe 23.5% të totalit të kredisë për bizneset, ndërsa pesha e kredisë për bizneset e mëdha ra në 51.8%³². Gjatë periudhës, për të tre llojet e bizneseve të ndara sipas madhësisë, është vërejtur rritje e peshës së kredisë afatmesme. Kjo dukuri ka qenë më e theksuar në rastin e biznesit të mesëm³³. Për biznesin e mesëm dhe biznesin e madh është rritur pesha e kredisë në lekë, ndërsa për biznesin e vogël është rritur pesha e kredisë në valutë³⁴.

Grafik 28. Struktura e kredisë së bizneseve sipas madhësisë dhe afatit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

³² Këto vlera shënonin përkatësisht: 55.5% (B. i madh); 22.8% (B. i mesëm) dhe 21.7% (B. i vogël) në dhjetor 2017; ndërsa në qershor 2018, ato ishin përkatësisht: 52.7%; 22.9%; dhe 24.4%.

³³ Në terma vjetorë, të tre llojet e bizneseve kanë rritur kredinë afatgjatë dhe kanë ulur atë afatshkurtër.

³⁴ Në terma vjetorë, të tre llojet e bizneseve kanë rritur peshën e kreditimit në monedhë të huaj, përkundër rënies së asaj në monedhën vendase, ku spikat biznesi i madh.



(38) Cilësia e portofolit të kredisë për bizneset ka shënuar përmirësim në të gjithë përbërësit e saj, gjatë periudhës dhe në terma vjetorë. Në dhjetor 2018, raporti i kredisë me probleme për bizneset (RKP) zbriti në nivelin 14.3%, nga 17.1% dhe 16.9% përkatësisht në qershor 2018 dhe dhjetor 2017.

HAPËSIRË INFORMUESE 5.2: REZULTATET E VROJTIMIT MBI GJENDJEN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E NDËRMARRJEVE


Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së ndërmarrjeve kryhet çdo gjashtë muaj, që prej vitit 2010. Duke filluar nga gjashtëmuajori i parë të vitit 2016, ky vërtetim është hedhur në terren me një kampion të zgjeruar prej rreth 1200 ndërmarrjesh të të gjitha përmasave, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë.

Gjatë periudhës, bizneset raportojnë se problematikat lidhur me **aksesin në financim** dhe **kostot e financimit** vlerësohen në rritje nga ndërmarrjet e mesme, por në zbutje nga ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha.

Konkurrenca dhe **gjetja e tregut** vijojnë të konsiderohen si sfidat kryesore për aktivitetin e ndërmarrjeve. Gjatë periudhës, rëndësia e konkurrencës vlerësohet disi në rritje për ndërmarrjet e mesme, por në rënie për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, ndërsa problematikat lidhur me gjetjen e tregut vlerësohen në zbutje.

Ecuria e shitjeve vlerësohet në rritje gjatë gjashtëmuajorit të dytë 2018, për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, dhe në rënie për ndërmarrjet e vogla, por është përmirësuar krahasuar me periudhën e kaluar. Në linjë me ecurinë e shitjeve, ndërmarrjet e vogla vijojnë të vlerësojnë ulje të **rezultatit financiar**, ndërkohë që ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha kanë vlerësuar rritje të tij gjatë periudhës. Ecuria pozitive e nivelit të shitjeve dhe të rezultatit financiar është reflektuar edhe në **zgjerimin e veprimtarisë** së ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, ndërkohë që ndërmarrjet e vogla nuk kanë raportuar zgjerim të veprimtarisë së tyre gjatë periudhës. Pritjet e ndërmarrjeve të të gjitha madhësive paraqiten pozitive lidhur me shitjet, rezultatin financiar dhe zgjerimin e veprimtarisë, por subjektet shprehen më pak optimiste në krahasim me gjashtëmuajorin e kaluar, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të vogla.

Gjatë periudhës, **më shumë gjysma e totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura e kanë financuar veprimtarinë e tyre përmes shitjeve**. Huamarrja, si burim më vete apo i kombinuar, është përdorur nga 19.4% e ndërmarrjeve të mëdha, 17.8% e ndërmarrjeve të mesme dhe 14% e ndërmarrjeve të vogla. Rreth 42.2% e totalit të ndërmarrjeve (464 ndërmarrje gjithsej) shprehen se kanë një **hua për të paguar**. Kjo peshë ka shënuar një rënie të lehtë krahasuar me gjashtëmuajorin e parë 2018 për ndërmarrjet e mëdha dhe të mesme, dhe rritje me 2.8 pikë përqindje (p.p.) në rastin e ndërmarrjeve të vogla. Rreth 85.4% e totalit të ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar bankave për të siguruar hua dhe kjo peshë ka rënë me 3 p.p. në terma gjashtëmuajorë dhe me 6 p.p. në terma vjetorë. Për totalin e burimeve formale, pesha e ndërmarrjeve huamarrëse arrin në 90.5% (banka dhe institucione financiare jobanka), duke mbetur e pandryshuar nga periudha e kaluar.



Rreth 75% e ndërmarrjeve të vogla, 78.9% e ndërmarrjeve të mesme dhe 79.7% e atyre të mëdha, e konsiderojnë **të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes** për financimin e veprimtarisë. Krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2018, kjo peshë rezulton më e lartë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve.


Përsa i përket monedhës së huamarrjes së ndërmarrjeve, gjatë periudhës, 46% e ndërmarrjeve të vogla, 49.3% e ndërmarrjeve të mesme dhe 35.7% e ndërmarrjeve të mëdha, deklarojnë e huaja e tyre është **vetëm në monedhën vendase**, ndërsa pjesa tjetër është në valutë (euro dhe/ose dollarë) dhe/ ose e kombinuar (lekë dhe valutë). Huamarrja **në monedhën evropiane** rezulton më e përdorur nga ndërmarrjet e mëdha (53% e tyre), duke tejkaluar monedhën vendase, dhe më pak nga ndërmarrjet e mesme (41.3%). Në rastin e ndërmarrjeve të vogla, peshat e ndërmarrjeve që kanë marrë hua në lekë dhe në euro, kanë rezultuar pothuaj të njëjta.

Huamarrja e re gjatë periudhës deklarohet nga 10.7% e ndërmarrjeve të vogla, 6.5% e ndërmarrjeve të mesme dhe 8.9% e ndërmarrjeve të mëdha. Pesha e huamarrësve të rinj është rritur në rastin e ndërmarrjeve të vogla, si në terma gjashtëmujorë ashtu dhe vjetorë, ndërkohë që ka qenë në rënie në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha.

Procesi i huamarrjes nga bankat vlerësohet midis nivelit “normal” dhe “i vështirë”, ndërsa **rëndësia e marrëdhënies me bankat** vlerësohet midis nivelit “e rëndësishme” dhe “e domosdoshme”, dhe në rritje gjatë periudhës, për të tre grupet e ndërmarrjeve (të vogla, të mesme dhe të mëdha).

(39) Ngarkesa me borxh e bizneseve ka shënuar një rënie të lehtë gjatë periudhës dhe vlerësohet në nivele të përballueshme nga bizneset. Në bazë të vërtetimit mbi gjendjen financiare dhe huamarrjen e bizneseve, rezulton se rreth 42.2% e bizneseve të anketuara kanë një hua për të paguar, dhe ky raport ka shënuar një rënie të lehtë me 1.3 pikë përqindje krahasuar me periudhën e kaluar. Pesha e bizneseve huamarrëse është më e lartë në sektorin e tregtisë (56.1%) dhe në sektorin e ndërtimit (45.3%), por këto pesha kanë rënë në krahasim me periudhën e mëparshme. Vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes për 79.5% të ndërmarrjeve huamarrëse. Ngarkesa e borxhit është më e lartë tek ndërmarrjet e mëdha. Rreth 22.6% e ndërmarrjeve të mëdha deklarojnë se vlera e huasë është e barabartë ose më e madhe se vlera e kapitalit. Duke i analizuar rezultatet e përgjigjeve sipas sektorëve, rezulton se gjatë periudhës, sektori i tregtisë ka peshën më të lartë të ndërmarrjeve që kanë një ngarkesë huaje mbi vlerën e kapitalit të ndërmarrjes, i ndjekur nga sektori i industrisë.

Grafik 29. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe raportit hua/kapital



Burimi: Banka e Shqipërisë.




Tabelë 4. Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje më të lartë se kapitali, sipas sektorëve

	Industri	Shërbime	Ndërtim	Tregti
6MII 2016	11.0%	7.0%	8.0%	9.0%
6MI 2017	7.9%	15.7%	5.8%	13.1%
6MII 2017	10.2%	11.9%	7.3%	8.3%
6MI 2018	10.3%	6.3%	4.3%	6.7%
6MII 2018	7.7%	5.0%	6.3%	10.2%

(40) Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (73.5%) deklarojnë se pagesa e huasë arrin deri në 20% të të ardhurave të tyre, dhe kjo peshë ka rënë me 1.8 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës. Barra e pagesës së huasë rëndon më tepër tek ndërmarrjet e vogla, për të cilat numri i ndërmarrjeve që raportojnë se kjo pagesë e kalon 20% të të ardhurave, zë rreth 33% të totalit të grupit³⁵. Për ndërmarrjet e mesme, kjo peshë është 24%, ndërsa për ato të mëdha, pesha është 25.5%.

Grafik 30 Shpërndarja e ndërmarrjeve dhe e raportit të pagesës (majtas) dhe ndryshimet përkatëse (djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.


(41) Kërkesa për kredi nga ana e bizneseve mbetet e moderuar. Rreth 49% e ndërmarrjeve të përgjigjura kanë deklaruar se "nuk ka asnjë mundësi" që të kërkojnë një kredi bankare në gjashtëmujorin e ardhshëm. Kjo peshë rezulton në rënie për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha, dhe lehtësisht në rritje në rastin e ndërmarrjeve të vogla.

(42) Indeksi i vlerësimit të planifikimit të huamarrjes për gjashtëmujorin e ardhshëm, krahasuar me periudhën e kaluar, ka shënuar rënie për ndërmarrjet e vogla dhe ka mbetur i pandryshuar për ndërmarrjet e mëdha. Nga ana tjetër, ky indeks është rritur dukshëm në rastin e ndërmarrjeve të mesme, duke

³⁵ Llogaritur si shumë e peshave të përgjigjeve: "20-50% të të ardhurave", "50-80% të të ardhurave" dhe "mbi 80% të të ardhurave".




Grafik 31. Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas planifikimit të huamarrjes



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 32. Indeksi i planifikimit të huamarrjes



Shënim: Indeksi është llogaritur duke ponderuar peshat e përgjigjeve të ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve sipas një koeficienti, i cili rritet me rritjen e mundësisë së huamarrjes. Koeficienti për alternativën "nuk ka asnjë mundësi" = 0.25, "ka pak mundësi" = 0.5, "ka shumë mundësi" = 0.75, "është e sigurt" = 1.0.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

treguar që, në krahasim me ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, ndërmarrjet e mesme kanë gatishmëri më të lartë për të marrë hua gjatë gjysmës së parë të vitit 2019.

